



Marrëveshjet për Elimiminin e Tatimit të Dyfishtë dhe Kosova

Prill, 2022

Rreth Analizës Tematike

Analiza Tematike është një publikim i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (AmCham Kosova) i cili synon të sjellë vëmendjen në politika të ndryshme ekonomike dhe të përvijojë sfidat për zhvillimin e politikave të tilla, në mënyrë që të hapë rrugën për adresimin e tyre. Ky botim vë në qendër të vëmendjes Marrëveshjet për Tatimin e Dyfishtë dhe Kosovën.

Hyrje

Aktivitetet dhe transaksionet ndërkufitare mund të shkaktojnë pasoja tatimore sipas ligjeve të brendshme tatimore të vendeve të ndryshme. Kjo ndodh sepse sovraniteti i shteteve të përfshira u lejon atyre të drejtën për të vendosur tatime. Rrjedhimisht, kjo krijon rrezik për tatim të dyfishtë.

Në ditët e sotme, vendet përpiqen gjithmonë të përfshijnë eliminimin e tatimit të dyfishtë gjatë hartimit të politikave të tyre tatimore, e kjo rezulton në aplikimin e Marrëveshjeve për Tatimin e Dyfishtë të cilat ndihmojnë në arritjen e këtij qëllimi.

Kjo analizë tematike ofron informacione të përgjithshme mbi Tatimin e Dyfishtë Ndërkombëtar dhe Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimeve të Dyfishta (METD) si një mënyrë për ta eliminuar atë.

Theks i veçantë i kushtohet trajtimit të kësaj çështjeje në shtetin e Kosovës.

Tatimi i Dyfishtë Ndërkombëtar - Vështrim i përgjithshëm

Tatimi i dyfishtë ndërkombëtar ndodh kur autoritetet publike të vendeve të ndryshme vendosin të njëjtin tatim, për të njëjtin tatimpagues, në të njëjtën periudhë kohore.

Aktivitetet dhe transaksionet ndërkufitare mund të shkaktojnë pasoja tatimore sipas ligjeve të brendshme tatimore të vendeve të ndryshme. Kjo ndodh sepse sovraniteti i shteteve të përfshira u lejon atyre të drejtën për të vendosur tatime. Kështu, kjo krijon një rrezik që dy vende të mund të kenë të drejtën të tatojnë të njëjtën gjë në duart e të njëjtit person.

Tatimi i dyfishtë mund të jetë ekonomik ose juridik. Tatimi i dyfishtë ekonomik lind në tatimin ndërkombëtar atëherë kur i njëjti transaksion ekonomik, artikull ose e ardhur taton në dy ose më shumë shtete gjatë së njëjtës periudhë por në duart e tatimpaguesve të ndryshëm. Ndersa në tatimin e dyfishtë juridik, dy ose më shumë shtete vendosin tatimet përkatëse të tyre mbi të njëjtin subjekt ose person, mbi të njëjtat të ardhura dhe për të njëjtat periudha. (Rohatgi 2005)

Kur bëhet fjalë për tatimin e dyfishtë ndërkombëtar, këto dy parime janë të një rëndësie të veçantë:

1. Parimi mbarëbotëror i tatimit:

Ky parim paraqitet kur të ardhurat e fituara jashtë vendit, përfshihen në bazën tatimore vendore. Pra, vendi i cili e aplikon parimin mbarëbotëror, përcakton që banorët e tij do të taton mbi të ardhurat e tyre të krijuara në mbarë botën, qofshin ato të ardhura që rrjedhin nga burime brenda ose jashtë territorit të tij (OECD, oecd-ilibrary.org 2014).

2. Parimi tatimor i territorialitetit:

Ky parim ndodh kur jorezidentët taton sipas burimit të të ardhurave, që do të thotë se tatimpaguesi, qoftë person fizik apo juridik, duhet t'ia paguajë tatimin shtetit në territorin e të cilit janë krijuar të ardhurat (Peci 2017). Vendet që e aplikojnë këtë parim, përjashtojnë të ardhurat nga vendet e huaja dhe tatojnë vetëm të ardhurat vendore.

Kombinimi i këtyre dy parimeve është shkaku kryesor që çon në tatim të dyfishtë ndërkombëtarë. Por gjithashtu, ai mund të ndodhë edhe kur respektohet i njëjti parim i vetëm mirëpo nga të dy shtetet e përfshira.

Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë

Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë, të quajtura ndryshe edhe Traktate Tatimore apo Konventa, janë marrëveshje ndërmjet shteteve sovraane, të cilat hartohen për të zbutur/eliminuar tatimin e dyfishtë (duke përcaktuar masën në të cilën çdo shtet mund të vendosë tatimin), për të parandaluar evazionin fiskal dhe për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet shteteve nënshkruesve.

METD-të kanë të bëjnë me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin dhe krijojnë bazën ligjore për të gjithë individët ose kompanitë që janë subjekt tatimor në dy vendet që negociojnë marrëveshjen.

Këto traktate konsiderohet të kenë një natyrë të dyfishtë: nga njëra anë, janë marrëveshje ndërmjet qeverive të dy shteteve për ndarjen e juridiksionit fiskal dhe nga ana tjetër, bëhen pjesë e legjislacionit tatimor të secilit shtet (që është palë në të), qoftë me përfshirjen e tyre në legjislacionin vendor, qoftë me zbatimin e tyre si një marrëveshje dypalëshe e ratifikuar nga shteti. (Peci 2017)

METD-të janë nominalisht reciproke. Nëse flukset e kapitalit janë të barabarta ndërmjet vendeve, duke aplikuar METD-të, vendet do të zbatonin edhe drejtësinë; atë që një vend e humbet nga ana e burimit, e plotëson nga ana e rezidencës. Nëse flukset e kapitalit nuk janë aq të barabarta, pasojat në të ardhura mund të jenë të konsiderueshme. (UN n.d.)

Objektivat e METD-ve:

Fillimisht, fokusi i traktateve tatimore ishte pothuajse ekskluzivisht në zgjidhjen e problemit të tatimit të dyfishtë. (UN n.d.). Por METD-të sot kanë edhe objektiva të tjera të rëndësishme, sic janë: parandalimi i evazionit dhe shmangies së tatimeve apo mos-tatimit të dyfishtë; eliminimi i diskriminimit ndaj shtetasve të huaj dhe jorezidentëve; lehtësimi i bashkëpunimit administrativ ndërmjet shteteve kontraktuese (që përfshin: shkëmbimin e informacionit, ndihmën në mbledhjen e tatimeve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve); ofrimi i sigurisë juridike për tatimpaguesit; promovimi i marrëdhënieve të ndërsjella ekonomike, i tregtisë dhe investimeve etj.

Model Konventat

METD-të zakonisht bazohen në konventat e modeleve të mëposhtme:

1. Modeli i OECD-së - Konventa Tatimore mbi të Ardhurat dhe Kapitalin. (OECD, oecd.org 2017)
2. Modeli i Kombeve të Bashkuara – Konventa për Tatimin e Dyfishtë ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. (Nations 2017)

Përdorimi i tekstit të këtyre model konventave është në diskrecionin e shteteve, të cilat janë të lira të vendosin nëse duan të përfshijnë të gjithë apo vetëm një pjesë të tekstit të model konventës në marrëveshjen e tyre. Kështu, teksti i model konventave është vetëm një format i rekomanduar për përdorim, zbatim i të cilit nuk është i detyrueshëm.

Interpretimi i traktateve, duke përfshirë traktatet tatimore, bëhet në bazë të rregullave të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve.

METD-të dhe Kosova

Marrëdhënia ndërmjet traktateve (traktateve tatimore) dhe ligjit të brendshëm të Kosovës rregullohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe gjithashtu me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

Në nenin e 19 të Kushtetutës thuhet: (Kosovo 2008)

1. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.
2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

Dhe, në nenin 15 (paragrafi 2) të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare thuhet:

“Nëse një marrëveshje ndërkombëtare në fuqi e Republikës së Kosovës vendos norma të tjera, përveç atyre të vendosura me ligje ose akte të tjera ligjore të Republikës së Kosovës që janë në fuqi në momentin e lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare ose të cilat kanë hyrë në fuqi pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare, atëherë dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare të Republikës së Kosovës mbizotërojnë.” (Kosovo, Law on International Agreements n.d.)

Administrata Tatimore e Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të Marrëveshjeve për Tatimin e Dyfishtë. Ajo ofron shërbime për tatimpaguesit që mbulojnë nga METD-të ndërmjet Kosovës dhe çdo vendi tjetër dhe gjithashtu përcakton procedurat për zbatimin e këtyre marrëveshjeve. (ATK n.d.)

Kosova është palë e 21 Marrëveshjeve për Tatimin e Dyfishtë, tre prej të cilave datojnë nga ish-Jugosllavia dhe dy prej të cilave nuk janë ende të zbatueshme.

Shumica e këtyre marrëveshjeve janë negociuar me shtetet përkatëse, ndërsa marrëveshjet e nënshkruara nga Ish Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë janë trashëguar nga Kosova dhe aplikimi i tyre ka vazhduar në shtetin e Kosovës. (Abdullahu 2019)

Më poshtë gjeni një tabelë të përgatitur nga të dhënat e ofruara nga uebfaqja e administratës Tatimore të Kosovës për METD-të ndërmjet Kosovës dhe vendeve tjera.

Shteti	Në fuqi nga Kosova	E zbatueshme	Komente	Dividendët	Interesi	Tantiemat
<i>Austria</i>	31.12.2018	01.01.2019		15%	10%	0%
<i>Belgjika</i>	23.02.2010	13.04.2012	Nga Ish Jugosllavia	10/15%	15%	10%
<i>Britania e Madhe</i>	09.07.2015 September 2010	01.01.2016 January, 2011		5/15% 15%	10% 0%	10% 0%
<i>Emiratet e Bashkuara Arabe</i>	03.07.2017	01.01.2017		5%	5%	5/10%
<i>Dukata e Madhe e Luksemburgut</i>	23.07.2019	01.01.2020		0/10%	5%	0%
<i>Finlanda</i>	02.09.2011	02.09.2011	Nga Ish Jugosllavia	5/15%	0%	10%
<i>Gjermania</i>	02.09.2011	02.09.2011	Nga Ish Jugosllavia	15%	0%	0%
<i>Holanda</i>	31.12.2021	01.01.2022		15%	10%	0%
<i>Hungaria</i>	13.01.2014	01.01.2015		0/5%	0%	0%
<i>Irlanda</i>	24.02.2022	01.01.2023				
<i>Italia</i>	Ende nuk ka hyrë në fuqi	Ende nuk është e zbatueshme				
<i>Kroacia</i>	04.12.2017	01.01.2018		5/10%	5%	5%
<i>Letonia</i>	22.11.2021	01.01.2022		0/10%	0/10%	0/5%
<i>Lituania</i>	Ende nuk ka hyrë në fuqi	Ende nuk është e zbatueshme		0/15%	10%	0%
<i>Malta</i>	20.09.2019	01.01.2020		0/10%	0/10%	0/10%
<i>Maqedonia</i>	06.06.2011	01.01.2014		0/5%	10%	10%
<i>Mbretëria e Arabisë Saudite</i>	01.08.2020	01.01.2021		5%	5%	0%
<i>Sllovenia</i>	14.04.2014	01.01.2015		5/10%	5%	5%
<i>Shqipëria</i>	28.09.2004 25.04.2014	01.01.2005 01.01.2016		5/8%	10%	10%
<i>Turqia</i>	08.11.2012	01.01.2016		5/10%	10%	10%
<i>Zvicra</i>	10.10.2018	01.01.2019		5/10%	5%	0%

Ndikimi i METD-ve në Kosovë

Edhe pse METD-të janë hartuar në bazë të parimit të mosdiskriminimit, ndikimi i tyre në vendet në zhvillim si Kosova, në praktikë, nuk e tregon këtë.

Shembull:

METD ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës

Shtetasi kosovar që realizon të ardhura në shtetin e Zvicrës, për të ardhurat e tij do të tatohet nga shteti i Zvicrës (shteti i burimit të të ardhurave të tij) dhe anasjelltas.

De Jure, kjo marrëveshje siguron mos-diskriminim dhe trajtim të barabartë. Por *de facto*, këto dy vende janë të pabarabarta që në fillim, sepse nga pikëpamja zhvillimore janë krejtësisht të kundërta me njëra-tjetrën.

Kjo shpjegohet me faktin se numri i shtetasve kosovarë që gjenerojnë të ardhura në Zvicër është shumë i madh, ndërsa e njëjta gjë nuk ndodh me numrin e shtetasve zviceranë që krijojnë të ardhura në Kosovë.

Kështu, vendet më të zhvilluara si Zvicra, përfitojnë më shumë nga këto marrëveshje sepse tërheqin më shumë punëdhënës dhe fitojnë të ardhura nga taksat e tyre, ndërsa qytetarët zviceranë nuk kanë interes të punojnë dhe të krijojnë të ardhura në Kosovë pasi që ajo nuk ka një ekonomi të zhvilluar dhe kjo rezulton në gjithashtu mjedis jo i favorshëm i punës.

Ky shembull paraqet disavantazhin e zbatimit të METD-ve në Kosovë, por në anën tjetër, nëse Kosova fokusohet në krijimin e një klime të mirë biznesi dhe arrin të i mbajë norma e ulëta tatimore, këto marrëveshje do të ishin shumë të dobishme për faktin se do të kontribuonin në tërheqjen investitorëve e huaj, gjë që do të rezultonte në fitime të larta për vendin.

Konkluzionet dhe Rekomandimet

Konkluzionet:

Tatimi i Dyfishtë Ndërkombëtar është një shqetësim serioz me të cilin po përballen shtetet, e të cilat vazhdimisht tentojnë ta zgjidhin këtë problem përmes Marrëveshjeve për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (të quajtura edhe Konventat ose Traktatet Tatimore).

Këto marrëveshje, me përjashtim të objektivit të tyre për eliminimin e tatimit të dyfishtë, synojnë edhe shmangien e evazionit fiskal ose mostatimin, gjithashtu synojnë të ndikojnë pozitivisht në bashkëpunimin ndërmjet shteteve kontraktuese, të nxisin marrëdhëniet e ndërsjella ekonomike, tregtinë, investimet etj.

Një nga parimet bazë të METD-ve është parimi i mosdiskriminimit, i cili gjithmonë përfshihet në marrëveshje, por *de facto* nuk është i zbatueshëm për vendet në zhvillim si Kosova. Pra, palët pajtohen për të drejta të ndërsjella/të barabarta, por meqenëse Kosova (në këtë rast) si vend në zhvillim, në parim nuk është e barabartë me një vend të zhvilluar, pikat e përfshira në marrëveshje mund të jenë diskriminuese për të.

Rekomandimet e Odës

Përkundër këtyre sfidave, nëse Kosova arrin të jetë e kujdesshme që të mos rrisë normat e tatimore dhe në të njëjtën kohë të zbatojë këto marrëveshje për eliminim të tatimit të dyfishtë, METD-të do të kontribuonin shumë për vendin tonë dhe do të ishin shumë të nevojshme për të tërhequr investitorët e huaj. Përfitimet që do të vinin nga investitorët e huaj do të kompensonin sfidat e Kosovës si vend me një ekonomi të pazhvilluar, prandaj zbatimi i METD-ve do të ishte shumë fitimprurës dhe efektiv.

Referencat

- Abdullahu, Flamur. 2019. *klsc.eu*. https://klsc.eu/wp-content/uploads/2019/06/Trajtim-i-shkurter-i-Marrevshjeve-per-Elimininimin-e-Taksimit-te-Dyfishte_Final-1-1.pdf.
- ATK. n.d. *atk-ks.org*. https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2017/12/Marrveshja-per-eliminimin-e-tatimit-te-dyfisht_Shqip.pdf.
- Kosovo, Republic of. 2008. *Constitution of the Republic of Kosovo*.
- Kosovo, Republic of. n.d. *Law on International Agreements*. 2011.
- Nations, United. 2017. *un.org*. https://www.un.org/esa/ffd/wp-content/uploads/2018/05/MDT_2017.pdf.
- OECD. 2017. *oecd.org*. <https://www.oecd.org/ctp/treaties/model-tax-convention-on-income-and-on-capital-condensed-version-20745419.htm>.
- . 2014. *oecd-ilibrary.org*. <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/9789264218789-5-en.pdf?expires=1649960095&id=id&accname=guest&checksum=5DC5814E04AF35F0DA710B8F33E601D1>.
- Peci, Bedri. 2017. *Shkenca mbi Financat dhe e Drejta Financiare*. Prishtina: University of Prishtina.
- Rohatgi, Roy. 2005. *Basic International Taxation*. Richmond Law & Tax Ltd.
- UN. n.d. *un.org*. https://www.un.org/esa/ffd/wp-content/uploads/2014/10/2STM_Taxation-EC18-2006-7-part1-R.pdf.